

**DRAFT PROJEKTLIGJ
“PËR BLETARINË”**

Në mbështetje të neneve 78, dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

**KREU I
KUSHTE TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim të njohë bletarinë si veprimtari me interes jetësor, kombëtar, e dobishme për ruajtjen e mjedisit natyror, ekosistemit dhe bujqësisë në përgjithësi dhe që synon garantimin e pjalmimit natyror dhe biodiversitetit të llojeve të bletëve, me referencë të veçantë për mbrojtjen e racës së bletës (*Apis mellifera carnica*) e popullata tipike vendase të bletëve ose zonave kufitare.

**Neni 2
Përkufizime**

Termat e përdorura në këtë ligj kanë kuptimin si vijon:

1. “Bletari”, nënkupton mbarështimin e bletëve dhe përfshin të gjitha aspektet e sektorit: njohuri për bletët, produktet e bletëve, përdorimet dhe tregjet e tyre, tregtinë dhe pajisjet;
2. “Apiterapi”, nënkupton përdorimin mjekësor të produkteve të prodhuara nga bletët, si mjalti, propolisi, dylli, poleni, qumështi i bletës dhe helmi, për të trajtuar çështje të ndryshme mjekësore dhe terapi inhalatore;

3. “Apiturizëm”, nënkupton turizimin e bletëve, ku përfshihen vizitat në parkun e bletëve, njohja me aktivitetet dhe jetën e bletës, kontakti direkt me bletarë, degustimi i produkteve të bletës në vend, etj.;
4. “AKVMB”, nënkupton Agjencinë Kombëtare të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve;
5. “AREB”, nënkupton Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor në qarqe;
6. “Biodiversitet”, nënkupton shumëllojshmërinë e përgjithshme të organizmave të gjallë, duke përfshirë ndërveprimet ekologjike, popullatat dhe komunitetet në të cilat ata jetojnë;
7. “Bletë”, nënkupton çdo insekt hymenopteran të superfamiljes Apoidea, duke përfshirë speciet sociale dhe të vetmuara;
8. “Bletari shtegtuese”, nënkupton një formë bletarie ku kolonitë transportohen për të ndjekur lulëzimin për prodhimin e mjaltit ose për të pjalmuar me porosi kulturat bujqësore (p.sh. bajamet, agrumet, domatet në sera), në plantacione dhe serra;
9. “Bletar”, nënkupton çdo person fizik/juridik, që njeh dhe mbron jetën e bletës, mbarështon dhe përfiton nga produktet e saj dhe bën pjesë në Shoqatën Lokale të Bletërritësve;
10. “Bletar amator”, nënkupton çdo person fizik/juridik, që bletërritjen e ka aktivitet dytësor dhe zotëron deri në 10 koshere;
11. “Bletar profesionist”, nënkupton çdo person fizik/juridik, që ushtron dhe promovon veprimtarinë e bletërritjes si aktivitet parësor, është i regjistruar pranë Shoqatës Lokale të Bletërritësve, dhe ka mbi 10 koshere;
12. “Parku i bletëve”, nënkupton tërësinë e bletëve të një bletari;
13. “Bletërritja”, nënkupton mbarështimin e bletëve mjaltëdhënëse;
14. “FKBSH”, nënkupton Federatën Kombëtare të Bletërritësve të Shqipërisë, grupim i shoqatave lokale të bletërritësve;
15. “Koloni”, nënkupton një grup organizmash të së njëjtës specie ose grup që jetojnë ose rriten së bashku;
16. “Koshere”, nënkupton banesën e bletës, pa bletë brenda;
17. “Ruajtja”, nënkupton mirëmbajtjen e burimeve, cilësive mjedisore dhe/ose biodiversitetit të një zone të caktuar. Zakonisht i referohet mbarështimit të një sistemi natyror nën presionin e përdorimit njerëzor, ose mbarështimit të specieve që kanë nevojë për mbrojtje;

18. “Kullotë mjaltëdhënëse”, ka kuptim e dhënë në legjislacionin përkatës “Për mbarështimin e blegtorisë”;
19. “Mbretëreshë”, nënkupton mëmën e kolonisë;
20. “Mjaltë natyral ”, nënkupton substancën e ëmbël natyrale të prodhuar nga bletët *Apis mellifera*, prej nektarit të luleve ose nga sekrecionet e pjesëve të gjalla të bimëve ose jashtëqitjet e insekteve që thithin bimët në pjesët e tyre të gjalla, të cilën bletët e grumbullojnë, transformojnë duke e kombinuar me substanca specifike të tyre, i depozitojnë, dehidratojnë, e ruajnë dhe e lënë në hojet e mjaltit për t’u pjekur dhe maturuar (stazhionuar);
21. “Mjaltë organik”, nënkupton mjaltin e prodhuar sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin për prodhimin organik;
22. “Ministria”, nënkupton ministrinë përgjegjëse për çështjet e bujqësisë;
23. “Ministri”, nënkupton ministrin përgjegjës për çështjet e bujqësisë;
24. “Shtegtim”, nënkupton një ose më shumë lëvizje të bletëve gjatë vitit, me qëllim rritjen e prodhimit; ;
25. “Regjistri RUDA”, nënkupton një sistem regjistrimi të kafshëve, i cili mbahet nga AKVMB;
26. “Sipërmarrës të lidhur me bletën”, nënkupton çdo person fizik/juridik, që ushtron biznes në mbështetje të bletërritjes (si p.sh prodhimi i koshereve, fletëve të dyllit, ushqimit të bletëve, pajisje për bletari, etj);
27. “Struktura përgjegjëse”, nënkupton strukturën në ministri që merret me bletarinë;
28. “PMB”, nënkupton produktet e mbrojtjes së bimëve, sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin përkatës “Për mbrojtjen e bimëve”;
29. “Vendndodhja”, nënkupton vendin e një e parkut të bletëve;
30. “Zgjua”, nënkupton kosheren që përmban një familje bletësh brenda.

Neni 3

Fusha e zbatimit dhe rëndësia e sektorit të Bletarisë

1. Ky ligj zbatohet në të gjithë parqet e bletëve nga bletarët të cilët janë persona fizikë ose juridikë dhe zotërojnë zgjoje dhe pajisje të nevojshme për zhvillimin e kësaj veprimtarie, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Bletaria është sektor shumë i rëndësishëm i mjedisit, bujqësisë dhe ekonomisë së vendit pasi:

- shërben si burim prodhimesh natyrale me vlerë të lartë ushqimore dhe mjekësore;
- bletët janë kontribues të rëndësishëm në sigurimin e rezervave ushqimore;
- përmes pjalmimit ose polenizimit ndikon në rritjen e prodhimit të shumë kulturave bujqësore, në cilësinë e tyre dhe në mbrojtjen nga dëmtues të ndryshëm
- ndikojnë në mbajtjen e florës së pyjeve dhe kullotave duke ripërtërirë natyrën si hallkë e zinxhirit ekologjik;
- shërben si aktivitet ekonomik që gjeneron të ardhura, në zonat rurale;
- mbështet dhe ofron shërbime të tjera, të tilla, si: apiturizmi, apiterapia dhe monitorimi i ndotjes së mjedisit.

Neni 4

Produktet e bletarisë

Konsiderohen produkte të bletarisë:

- Mjalti;
- Dylli i bletës;
- Qumështi i bletës;
- Poleni;
- Propolisi;
- Helmi i bletës;
- Mbretëresha dhe koloni bletësh, të cilat mund të tregtohen edhe në formën e Paketave të bletëve.

Neni 5

Regjistrimi në regjistër

1. Çdo individ, person fizik ose juridik, që merret me bletari, që zotëron 1 ose më shumë koshere, është i detyruar të regjistrohet në:
 - a. Regjistrin e fermës, pranë AREB-ve përkatëse;

- b. Regjistrin “RUDA”, pranë AKVMB-së përkatëse, deri në datën 30 prill të çdo viti kalendarik, për numrin dhe vendndodhjen e koshereve të bletëve;
 - c. Në Shoqatën Lokale të Bletërritësve.
2. Të dhënat e regjistrit lidhur me bletarinë, dërgohen nga AREB dhe AKVMB, në strukturën përgjegjëse, në ministri, në një afat prej 30 ditësh nga regjistrimi.
 3. Struktura përgjegjëse krijon dhe mban një regjistër për mbretëreshat, referuar dhe pikës 2, të nenit 57, të Ligjit “Për mbarështimin e blegtorisë”.
 4. Të dhënat e regjistrit do të jenë të aksesueshme nga institucionet e varësisë së ministrisë që lidhen me sektorin e bletarisë, si edhe nga Shoqatat e Bletërritësve, pas paraqitjes së kërkesës me shkrim për këtë qëllim.

Neni 6

Vendodhja e parkut të bletëve

1. Parku i bletëve duhet të vendoset jo më pak se 10 (dhjetë) metra nga rrugët e tranzitit publik dhe jo më pak se 5 (pesë) metra nga kufinj të pronës publike ose private.
2. Parku i bletëve mund të jetë i qëndrueshëm ose lëvizës.
3. Respektimi i distancave të përmendura në pikën 1, të këtij neni, nuk është i detyrueshëm nëse ka dallime në lartësi prej të paktën 2 (dy) metrash midis parkut të bletëve dhe vendeve të treguara në të ose nëse muret, gardhe ose strehëza të tjera të përshtatshme ndërpriten pa zgjidhje vazhdimësie dhe nuk lejojnë kalimin e bletëve. Këto strehime duhet të jenë të paktën 2 (dy) metra të larta. Megjithatë, marrëveshjet ndërmjet palëve të interesuara janë të këshillueshme.
4. Në rast të pranisë së konstatuar të fabrikave të prodhimit të sheqerit industrial, vendosja e parkut të bletëve duhet të respektojë një distancë minimale prej 1 (një) kilometër nga vendet e prodhimit.
5. Ndalohet vendosja e parkut të bletëve pranë autostradave, njësive të përpunimit të metaleve, inceneratorëve, zonave të ndotura, aeroporteve.

6. Të dhënat mbi vendosjen e parkut të bletëve, distancat, afërsia me struktura të prodhimit, përpunimit apo zonave të ndotura, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë me Bashkitë përkatëse.
7. Ndalohen aktivitete të ndryshme prodhuese industriale në afërsi të parqeve të cilat ndikojnë në dëmtimin e bletëve.

KREU II

LËVIZJA DHE TRANSPORTI I BLETËVE

Neni 7

Shtegtimi i bletëve

1. Shtegtimi i parkut të bletëve nga një vend në një vend tjetër për të shfrytëzuar kullotën është një praktikë që duhet nxitur për prodhimin e llojeve të ndryshme të mjaltit njëlulësh, pjalmimin e kulturave bujqësore, apo shmangien e kushteve të pafavorshme klimatike.
2. Çdo individ, person fizik apo juridik, që mbarështon bletë dhe kërkon të shtegtojë parkun e bletëve në një zonë tjetër, duhet të bëjë kërkesë në rrugë elektronike në AKVMB-në përkatëse, jo më vonë se 6 (gjashtë) ditë para datës së lëvizjes.
3. Kërkesa duhet të jetë e shoqëruar me certifikatën veterinare për gjendjen shëndetësore të bletëve dhe raportin për masat e ndërmarra veterinare.
4. AKVMB, pasi merr mendimin e ekspertit në bashkëpunim me Shoqata Lokale të Bletërritësve, miraton apo refuzon vendosjen e parkut të bletëve.
5. Çdo bletar pas miratimit të kërkesës për shtegtimin e bletëve në vendin e caktuar, duhet të ruajë distancën nga parqet e tjera me së paku 50 (pesëdhjetë) metra dhe të respektojë të gjitha detyrat e përcaktuara nga veterineri zyrtar për masat profilaktike dhe kurative që aplikohen në atë kohë në atë zonë.

Neni 8

Transporti i zgjojeve

1. Transporti i zgjojeve në parkun e bletëve mund të bëhet me të gjitha mjetet e transportit me kushtin, që të jenë të mbyllura për të penguar fluturimin e bletëve gjatë transportit.
2. Mjetet e transportit duhet të kenë të siguar ventilimin, gjatë transportit.
3. Gjatë transportit duhet të jetë i pranishëm një bletërritës për të evituar ndonjë rast të mundshëm incidenti me bletët. Këto transportues duhet të kenë me vete veshjet dhe të gjitha paisjet mbrojtëse.
4. Bletët të mos ndalohen më shumë se 30 minuta për çdo lloj arsye. Nga ana e kontrollorëve, të lejohet të shkojnë në destinacion, e në rast problematikash, veprimet të kryhen me personin përgjegjës, pas mbërritjes.

KREU III RIPRODHIMI I BLETËVE, KULLOTAT

Neni 9 Riprodhimi i bletëve

1. Për përzgjedhjen e bletëve duhet të përdoret lloji i bletës Evropiane *Apis Mellifera* dhe nënlojet lokale të bletëve; *Apis mellifera carnica* në vendet e Ballkanit, *Apis mellifera ligustica*, *Apis mellifera sicula*; *Apis mellifera cecropia*; *Apis mellifera mellifera*; *Apis mellifera macedonica*; *Apis mellifera caucasica*.
2. Për përzgjedhjen e llojit të bletëve, bletari duhet të ketë në konsideratë përshtatjen e llojit me kushtet lokale klimatike dhe rezistencën ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve të tjerë.
3. Importimi i mbretëreshave nga vendet e tjera duhet të kontrollohet nga Ministria dhe të jetë i shoqëruar me dokumentacionin përkatës, sipas përcaktimeve ligjore.
4. Importi i mbretëreshave do të bëhet vetëm për subjektet e autorizuara nga AKVMB.
5. Familjet e bletëve krijohen me shumim të familjeve ekzistuese të bletëve.

6. Qendrat riprodhuese për mbretëresha të bletëve, riprodhimi dhe tregtimi janë të përcaktuara në legjislacionin përkatës “Për mbarështimin e blegtorisë”.

Neni 10

Burimet e nektarit, Administrimi i kullotave të bletëve

1. Nektari, mjalti, poleni dhe propolisi janë prodhime të një cikli natyror me interes publik.
2. Për qëllime të një shfrytëzimi të përshtatshëm të prodhimit të nektarit, nxitet mbarështimi i bletëve dhe praktika ekonomiko-prodhuese e shtegtitimit.
3. Vendndodhja, sipërfaqja, lloji i kullotave, kapaciteti mjaltëdhënës, miratohen me vendim të këshillit të ministrave, pas përfundimit të studimit për këtë qëllim nga ministria.
4. Ministri, bazuar në të dhënat e studimit, miraton për një periudhë 5 (pesë) vjeçare programin e shfrytëzimit të kullotave.
5. Në rastet kur në një zonë të vetme janë disa shoqata bletërritësish, ato paraqesin një propozim të përbashkët të administrimit të kullotave mjaltëdhënëse për zonën përkatëse.
6. Në rastet kur në një territor të caktuar nuk ka shoqata bletërritësish, ose nëse një shoqatë e tillë nuk arrin të dalë me një propozim për administrimin e kullotës mjaltëdhënëse, propozimi bëhet nga Shoqata më e afërt Lokale e Bletërritësve. Nëse shoqata më e afërt nuk propozon, atëherë propozimi bëhet nga federata.
7. Federata Kombëtare e Bletërritësve të Shqipërisë përgatit një program monitorimi dhe parashikimi të kapacitetit nektaror dhe pjalmit, i cili miratohet nga Ministri, për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh. Programi zbatohet si shërbim publik në blegtori. Në program përfshihen edhe të dhëna për territorin, mënyra e mbledhjes së të dhënave, kushtet dhe mënyra e njoftimit të përdoruesve.
8. Struktura përgjegjëse në ministri, mban regjistrin për shfrytëzimin e kullotave mjaltëdhënëse. Regjistri i këtyre kullotave përmban bazën e të dhënave, ku jepet informacion për identifikimin, kapacitetin dhe llojet e kullotave, si dhe bëhet parashikimi i kapacitetit nektaror dhe pjalmit në rritjen e bletëve.

9. Kushtet e hollësishme për mbajtjen e regjistrit të kullotave mjaltëdhënëse, për mbarështimin e tyre, për lëvizjen e parqeve të bletëve në kullota, programi i parashikimit të kapacitetit nektaror dhe pjalmit, si dhe programi i shfrytëzimit, përcaktohen me udhëzim të Ministrit, i cili u dërgohet bletërritësve përmes shoqatave lokale apo federatës.

KREU IV MBROJTJA E BLETËVE

Neni 11 Mbrojtja e bletëve

1. Bletari është i detyruar të ketë njohuritë bazë mbi bletarinë.
2. Bletari është i detyruar që në parkun e vet të bletëve të ndërmarrë të gjitha masat për parandalimin, luftimin dhe pengimin e përhapjes së sëmundjeve duke përdorur vetëm produktet mjekësore veterinarë, të regjistruara dhe të aprovuara nga Ministria, në sasinë e rekomanduar nga mjeku veterinar.
3. Bletari është i detyruar të mbajë një regjistër për trajtimet mjekësore që ju kryen bletëve.
4. Masat profilaktike dhe luftimi i sëmundjeve të bletëve përcaktohet në fillim të çdo viti kalendarik për vitin vijues nga AKVMB, në bashkëpunim me ekspertët e fushës dhe Federatën Kombëtare të Bletërritësve të Shqipërisë (FKBSH), sipas legjislacionit përkatës, në fushën e veterinarisë.
5. Çdo bletar me rastin e dyshimit të paraqitjes së sëmundjeve me karakter përhapës siç janë: *Nozematoza*, *Varroatoza*, *Akarapidoza*, *Pesta Amerikane*, *Pesta Evropiane*, *Aetinoza*, *Tropilaelaps spp*, si dhe dëmtimeve të paignifikuar ose helmimet, detyrohet të lajmërojë menjëherë inspektorin veterinar për diagnostifikimin e sëmundjes, i cili ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e përhapjes së sëmundjes, sipas përcaktimeve të ligjit “Për veterinarinë”.
6. Ndalohet trajtimi me produkte mjekësore veterinarë të cilat nuk e kanë lejen për përdorim sipas legjislacionit përkatës.

7. Ndalohet përdorimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe materialeve të tjera të cilat përmes produkteve të bletës mund ta dëmtojnë shëndetin e njeriut.
8. Për mbrojtjen nga fatkeqësive natyrore (djegie, përmytje, dëmtime nga kafshët e egra, etj.), të nxiten bletarët të zbatojnë sigurimin vullnetar të aseteve të tyre.

Neni 12

Raportimi i zgjojeve të bletëve dhe komunikimi i fillimit të aktivitetit

1. Për qëllime të profilaksisë dhe kontrollit shëndetësor, kushdo që ka koloni bletësh është i detyruar ta komunikojë, pranë AKVMB, duke përfshirë edhe Shoqatat Lokale të Bletërritësve që veprojnë në zonë, duke specifikuar vendndodhjen dhe numrin e koshereve, brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe, më pas, deri në fund të prillit, pas dimërimit të viteve në të cilat ka pasur një ndryshim në vendndodhjen ose numrin e zgjojeve në një përqindje të barabartë me të paktën 10 për qind.
2. Kushdo që ndërmer veprimtarinë për herë të parë, kërkohet që:
 - a. ta komunikojë atë sipas pikës 1, të këtij neni;
 - b. të ketë ndjekur një kurs kualifikimi, i cili në varësi të aktivitetit që do të ndërmarrë bletari i ri, përbëhet nga dy module: moduli bazë me rregullat e sigurimit teknik të sjelljes me kolonitë e bletëve, vendosjes së tyre në territor, bazat e mbarështimit dhe mjekimit, si dhe moduli i avancuar, për bletarë profesionistë.
3. Modulet sipas shkronjës (b), të pikës 2, të këtij neni, duhet të jenë të hartuara dhe të aprovuara nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, ose të jenë pjesë e kurrikulave të miratuara nga Ministria përgjegjëse.
4. Raportet dhe komunikimet nga pika 1, e këtij neni, i adresohen shërbimeve veterinare të AKVMB-së dhe përcillen tek struktura përgjegjëse.
5. Mosplotësimi sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, heq të drejtën e përfitimit përmes masave mbështetëse të sektorit.

Neni 13

Asgjësimi i bletëve

1. Ndalohet asgjësimi i bletëve, përveçse në rastet e konfirmuara nga veterineri dhe të vërtetuara në mënyrë laboratorike nga laboratorët e akredituar, për prezencë të sëmundjeve ngjitëse të rrezikshme.
2. Asgjësimi bëhet në prezencë të inspektorëve veterinarë të AKVMB, zooteknikëve të AREB-ve, si dhe përfaqësuesve të Shoqatës Lokale të Bletërritësve. Nëse nuk ka shoqatë lokale do të jenë përfaqësuesit e federatës.
3. Dëmshpërblimi i dëmeve për asgjësimin e bletëve, kryhet sipas përcaktimeve të ligjit “Për veterinarinë”.

Neni 14

Përdorimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve

1. Në raste të domosdoshme të spërkatjes së bimëve, si në rastin e lulëzimit, bletarët lajmërohen me të gjitha format e komunikimit, nga organet e pushtetit vendor, 3 (tre) ditë përpara, për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e bletëve, sipas akteve ligjore lidhur me PMB-të.
2. Pas marrjes së njoftimit mbi vendin dhe kohën e spërkatjes së bimëve me produkte të mbrojtjes së bimëve helmuese për bletën, bletari është i detyruar të ndërmarrë të gjitha masat mbrojtëse duke i mbyllur dyert e zgjojeve ose duke larguar parkun e bletëve së paku 6 (gjashtë) km larg në vijë ajrore nga zona e spërkatjes.
3. Nëse bletari nuk i ndërmerr masat e përshtatshme sipas pikës 2, të këtij neni, nuk ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim nga askush për helmimin e bletëve.

Neni 15

Mbrojta e racës autoktone të bletëve

1. Mbrojtje e veçantë përcaktohet për racën vendase të bletëve *Apis Mellifera Carnica*, ku nxiten bletarët dhe instucionet e ndërlidhura të informojnë bletarët për përzgjedhjen e racës vendase, sipas përcaktimeve të ligjit “*Për mbarështimin e blegtorisë*”.
2. Për përzgjedhjen e llojeve të tjera të bletëve, bletari duhet të marrë në konsideratë përshtatjen e llojit, sipas përcaktimeve të nenit 9, të këtij ligji, ndaj kushteve lokale dhe rezistencën ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve, por gjithmonë duke marrë miratim nga ministria sipas legjislacionit përkatës për futjen e racave të reja në Republikën e Shqipërisë.

KREU V

Bletaria cilësore

Neni 16

Bletaria biologjike

Prodhimi biologjik i produkteve të bletës do të kryhet sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës për “*Prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre*”.

Neni 17

Skemat e Cilësisë për produktet e bletëve

Për produktet e bletëve të prodhuara në vend, për të shtuar vlerën dhe garantuar mbrojtjen e tyre, me: emërtim origjine të mbrojtur, tregues gjeografik të mbrojtur dhe specialitet tradicional të garantuar, fermerët, shoqatat, grupet e prodhuesve, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, aplikojnë për skemat e cilësisë, në mbështetje të legjislacionit përkatës “*Për Skemat e Cilësisë së Produkteve Bujqësore dhe Ushqimore*”.

Neni 18

Etiketimi i produkteve të bletës

1. Etiketimi i produkteve të bletëve bëhet në përshtatje me legjislacionin përkatës “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”, si edhe rregulloret përkatëse të produkteve.
2. Elementët e etiketës janë:
 - a) Emri ose emri tregtar dhe adresa e operatorit të biznesit ushqimor;
 - b) Lista e përbërësve,
 - c) Sasia e përbërësve ose e kategorive të caktuara të përbërësve sipas rendit zbritës;
 - ç) Sasia neto e produktit ushqimor;
 - d) Data e jetëgjatësisë minimale ose “të përdoret përpara datës ...”, duhet të vendoset për produktet e bletës, e në rastin e mjaltit të vendoset “për një periudhë 24 mujore, nga data e prodhimit”;
 - dh) Kushtet e veçanta të ruajtjes dhe/ose kushtet e përdorimit;
 - e) Shteti i origjinës ose vendi i prejardhjes, sipas parashikime të legjislacionit;
 - ë) Udhëzimet e përdorimit, kur, në mungesë të tyre, përdorimi i duhur i produktit ushqimor do të ishte i vështirë;
 - f) Deklarata e vlerave ushqyese;
 - g) Përshkrimi, për mjaltin “Nuk rekomandohet për fëmijët nën 1-vjeç”.
3. Në rast të importit të mjaltit, ose produkteve të tij, përveç elementëve të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, etiketa duhet të përmbajë dhe përcaktimin që është produkt importi si dhe shtetin nga vjen, si dhe duhet të jetë në gjuhën shqipe.

KREU VI
PJALMIMI, BLETARIA URBANE DHE USHQYERJA
Neni 19
Pjalmimi natyral

1. Aktiviteti i pjalmimit njihet si veprimtari bujqësore, thelbësorë për mbijetesën e njeriut sepse ndihmon në lehtësimin e prodhimit të ushqimit.
2. Bletët janë pjalmuese efikase dhe të besueshme. Ato janë mbledhëse metodike të nektarit dhe polenit, nuk e shkatërrojnë bimën dhe ruajnë biodiversitetin dhe produktivitetin e ekosistemeve natyrore dhe bujqësore.

3. Meqenëse bletët pjalmojnë mbi 80% të bimëve të lulëzuara të Tokës, duke përfshirë pothuajse të gjitha frutat dhe perimet, duhet të ndërmerren hapa për të rritur ndërgjegjësimin për nevojën për të mbrojtur bletët: rënia numrit të tyre mund të ketë një ndikim të paparashikueshëm në ekosistemet e Tokës.
4. Bletarët lejohen të blejnë, transportojnë dhe mbajnë sheqer dhe substanca të sheqerosura thelbësore për ushqimin e familjeve të bletëve, me detyrimin e mbajtjes së shënimeve të ngarkimit dhe shkarkimit të substancave me sheqer.

Neni 20

Bletaria urbane

1. Bletët janë kampionues të shkëlqyeshëm të lëvizshëm dhe bioindikatorë të ndotjes kimike, pasi ato vijnë në kontakt me një sërë ndotësish gjatë fluturimeve të tyre të kërkimit të ushqimit.
2. Për efekt të monitorimit të mjedisit, mbajtja e bletëve mbi tarracat e pallateve në zonat urbane, rregullohet nga organet e qeverisjes vendore, përmes marrëveshjeve dypalëshe me Shoqatën Lokale të Bletërritësve, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Përcaktimi i kushteve për mbajtjen e bletëve në mjediset urbane, miratohet me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe pushtetit vendor.

Neni 21

Ushqyerja e bletëve

1. Ushqyerja e bletëve me sherbet/sheqer apo shurupë të tjerë, nuk duhet të bëhet gjatë periudhës së lulëzimit kryesor të bimëve mjaltëdhënëse dhe mbledhjes së nektarit nga bletët.
2. Ushqyerja me sherbet/sheqer apo shurupë të tjerë, është i lejueshëm gjatë lulëzimit të bimëve mjaltëdhënëse, vetëm në rastet e reshjeve të zgjatura të shiut (për disa ditë me radhë, që nuk lejojnë daljen e bletës për të grumbulluar nektar) dhe me njoftimin paraprak të veterinerit zyrtar (ku të

- deklarohet sheqeri i përdorur dhe sasia e përdorur, dhe të gjitha veprimet të jenë të pasqyruara në regjistrin e bletarit, me datën përkatëse).
3. Ushqimet e tjera të përdorura për të ushqyer bletët (me bazë proteinike apo sheqerore si candy, pogaçe, etj) duhet të jenë të prodhuara vetëm nga stabilimente të licencuara dhe të kontrolluara nga autoritetet përkatëse të kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.
 4. Çdo ushqim i përdorur që është i pakontrolluar, mund të sjellë kontaminimin e paqëllimshëm të produkteve të bletës si p.sh mjaltit, qumështit të bletës, etj, dhe shkakton prodhimin e produkteve jo në përputhje me kriteret e cilësisë.

KREU VII

MBËSHTETJA E SEKTORIT TË BLETARISË

Neni 22

Mbështetja e sektorit të bletarisë

1. Për mbrojtjen e mjedisit dhe prodhimeve agropjore, hartohet një program për bashkërendimin e aktiviteteve për sektorin e bletarisë, në bashkëpunim me Shoqatat e Bujqësisë, Shoqatat e bletërritësve në nivel lokal dhe Federatën e Bletërritësve në nivel kombëtar, Shoqatat apo organizatat që mbështesin sektorin e bletarisë dhe me Organizatat në Mbrojtje të Konsumatorit.
2. Programi përmban udhëzimet për:
 - promovimin dhe mbrojtjen e produkteve shqiptare të bletëve dhe nxitjen e proceseve të gjurmueshmërisë sipas legjislacionit përkatës, për mbrojtjen e tyre;
 - zgjerimin e produkteve me emërtim origjine të mbrojtur, tregues gjeografik të mbrojtur, specialitet tradicional të garantuar, si dhe produkt biologjik, sipas legjislacionit në fuqi;
 - mbështetjen e shoqatave kombëtare ndërmjet bletërritësve dhe promovimin e marrëveshjeve profesionale;
 - zhvillimin e programeve të kërkimit dhe eksperimentimit të bletarisë, në marrëveshje me shoqatat e bletërritësve, universiteteve, etj;

- integrimin midis bletarisë dhe bujqësisë;
 - vlerësimet e përgjithshme mbi kufijtë dhe ndalimet të cilave mund t'i nënshtrohen trajtimet me pesticide me produkte fitosanitare dhe herbicide toksike për bletët në kulturat e pemëve, barishtore, zbukuruese, të kultivuara dhe spontane gjatë periudhës së lulëzimit;
 - përcaktimin e kufijve dhe ndalimeve për përdorimin e kulturave/bimëve mjaltëdhënëse që rrjedhin nga organizma të modifikuar gjenetikisht;
 - nxitjen e praktikës së pjalmimit me anë të bletëve;
 - nxitjen e praktikës së bletarisë dhe shtegtimit të bletëve;
 - mbrojtjen dhe mbjelljen e kulturave të reja të bimëve mjaltëdhënëse, polendhënëse, apo nektaro-polenike sipas biodiversitetit;
 - përcaktimin e ndërhyrjeve të rimëkëmbjes ekonomike dhe të kontrollit për luftën kundër *varrotozës* dhe sëmundjeve të tjera të bletëve;
 - forcimin dhe zbatimin e kontrolleve mbi produktet e bletëve me origjinë kombëtare, BE, dhe jashtë BE-së;
 - stimuj për të rinjtë për t'u vendosur dhe qëndruar në sektorin e bletarisë;
 - sigurimin e mbështetjes për bletarët që operojnë në zona malore ose të pafavorizuara;
 - mbrojtjen dhe përzgjedhjen e pastër të bletës shqiptare (*Apis mellifera carnica*) dhe racave të tjera të vendeve fqinje që janë përshtatur me kushtet e vendit tonë, sipas përcaktimeve të nenit 9, të këtij ligji, si dhe nxitjen e prodhimit të mbretëreshave shqiptare nga qendrat e seleksionimit gjenetik.
3. Programi, sipas pikës 1, të këtij neni, miratohet me urdhër të përbashkët të Ministrisë dhe ministrisë përgjegjëse për pyjet.

KREU VIII

PËRPUNIMI DHE RUAJTJA E MJALTIT

Neni 23

Mjetet për prodhimin/përpunimin e mjaltit

1. Personi fizik/juridik që kryen procesin e prodhimit/përpunimit dhe ruajtjes së mjaltit duhet të zotërojë mjetet e mëposhtme:
 - Për pranim, vjelje dhe mirëmbajtje të ambalazhit;

- Për përpunim, mbushje dhe paketim;
 - Për prodhimet e paketuara;
 - Për infrastrukturën.
2. Infrastruktura akomoduese e përpunimit dhe ruajtjes duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara në legjislacionin për ushqimin dhe rregullat e kontrollit HACCP.
 3. Subjektet duhet të jenë të regjistruara në QKB, sipas legjislacionit të fushës, me objekt të veprimtarisë prodhimin/përpunimin dhe ruajtjen e mjaltit.

Neni 24 **Kushtet e ruajtjes**

Mjalti duhet të ruhet në vende të thata, të errëta, në temperaturë më të ulët se 25°C dhe lagështi relative të ajrit nga 65% deri në 80%.

Neni 25 **Mbikqyrja**

Mbikqyrja do të kryhet nga inspektorët e veterinarisë dhe blegtorisë, sipas përcaktime ligjore.

KREU IX **KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE, MASAT DHE EKZEKUTIMI**

Neni 26 **Kundërvajtjet administrative**

Përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtëme:

- a. Ushtrimi i veprimtarisë së bletarisë në kundërshtim me nenin 5, të këtij ligji;

- b. Mosrespektimi i distancës së vendosjes së parkut të bletëve sipas nenit 6, të këtij ligji;
- c. Mos zotërimi i certifikatës së gjendjes shëndetësore të bletëve në rastin e lëvizjes së tyre sipas nenit 7, të këtij ligji;
- ç. Lëvizja e bletëve pa aprovimin e organit kompetent sipas nenit 7, të këtij ligji;
- d. Mos njoftimi i inspektorëve përkatës për dyshimin e paraqitjes së sëmundjeve me karakter përhapës sipas nenit 11, të këtij ligji.

Neni 27

Masat administrative

Për kundërvajtjet e parashikuara në nenin 26, të këtij ligji, merren masat administrative të mëposhtëme:

1. Për shkeljet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “ç”, gjobë nga 10,000 (dhjetë mijë) lekë deri në 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
2. Për shkeljet e parashikuara në shkronjat “c” dhe “d”, gjobë nga 20,000 (njëzet mijë) lekë deri në 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

Neni 28

Procedurat e kundërvajtjeve administrative

1. Procedurat e kundërvajtjeve administrative të parashikuara në nenin 26, të këtij ligji, realizohen nga institucioni i kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.
2. Kundër vendimit të masës administrative bëhet ankim në Komisionin e Shqyrtimit të Masave Administrative në institucionin e kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i vendimit.
3. Kundër vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Masave Administrative në institucionin e kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë bëhet ankim në gjykatë brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga njoftimi i vendimit.

Neni 29
Ekzekutimi i vendimit

Institucioni i kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë ekzekuton vendimin e formës së prerë të gjykatës në formën dhe parashikimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 30
Të ardhurat nga vjelja e gjobave

Të ardhurat që krijohen nga arkëtimi i gjobave kalojnë 100% në buxhetin e shtetit.

KREU X
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

NENI 31
Nxjerrja e aktetve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 10, pika 3, të këtij ligji, brenda 2 (dy) vjetësh nga hyrja në fuqi e ligjit;
2. Ngarkohet ministri të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10, pikat 4 dhe 7 dhe 10, pika 9, të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit;
3. Ngarkohet ministri dhe bashkia përkatëse të nxjerrë aktet nënligjore, në zbatim të nenit 6, pika 6, të këtij ligji.
4. Ngarkohet ministri dhe ministri përgjegjës për pushtetin vendor të nxjerrë aktet nënligjore, në zbatim të nenit 20, pika 3, të këtij ligji.
5. Ngarkohet ministri dhe ministri përgjegjës për pyjet të nxjerrë aktet nënligjore, në zbatim të nenit 22, pika 3, të këtij ligji

Neni 32
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi, 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare” dhe i fillon efektet pas 2 (dy) viteve nga botimi.

KRYETARI
LINDITA NIKOLLA

SHTOJCË

I. Modeli i kërkesës për lëvizjen e parkut të bletëve.

Drejtuar: Agjencisë Kombëtare të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve _____,
Qarku _____ Bashkia

Unë i nënshkruari, banor në adresën (Fshati, Bashkia, Qarku), pas marrjes së konfirmimit nga Shoqata e Bletërritësve _____, paraqes kërkesën për vendosjen e parkut të bletëve të përbërë nga koshere, në adresën (Fshati, Bashkia, Qarku), për periudhën nga deri më, për të shfrytëzuar kullotën për prodhimin e mjaltit (specifiko tipin e mjaltit); për të bërë të mundur pjalminin e kulturës bujqësore

Bashkëlidhur kërkesës është edhe certifikata shëndetësore e parkut të bletëve.

Emri/Mbiemri

Data:

Firma

__/__/__

DRAFT